

Në bazë të nenit 17, parag.2, nenit 18 parag.1 alinea 2 dhe parag.6 të Ligjit për Administratë Gjyqësore, dhe në lidhje me nen. 22 dhe nen. 23 të Ligjit për Marrëdhënie Pune, të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e konkursit publik ("Gazeta Zyrtare e RM", nr.43/14, 33/15, 98/15, 6/16, 198/18, 248/18 dhe G. Zyrtare të RMV nr.235/22), të Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës dhe të Dakordimit nga Këshilli Gjyqësor Buxhetor nr.08-248/3 datë 14.03.2023, Kryetari i Gjykatës Themelore Dibër, Mersim Marku, me datë 15.03.2023 shpall:

KONKURS PUBLIK nr.2/23

Për punësim e nëpunësve gjyqësorë në kohë të caktuar deri më 31.12.2023 për vendet e punës si në vijim:

1. Kategoria G, niveli G3, Referent gjyqësor - pranimi dhe ekspedimi i postës 1 (një) kryerës shifra SUD0101G03001

Kushtet e veçanta - kualifikime dhe kompetenca të nevojshme profesionale:

- të ketë së paku arsimin e mesëm ose të lartë,
- të ketë më së paku një vjet përvojë pune në profesion, dhe
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje aktive të njërës nga tri gjuhët më të përdorura në UE (angleze, franceze, gjermane).

Paga e nëpunësit gjyqësor do të jetë 19.929,00 denarë.

2.Higjieniste 1 (një) kryerës shifra UPR0405A03004

Kushtet e veçanta - kualifikime dhe kompetenca të nevojshme profesionale:

- arsim të mesëm ose arsim fillor
- me apo pa përvojë pune

Paga e punëtorit – higjienistit do të jetë 18.026,00 denarë.

Kandidatët përpos kushteve të veçanta për secilin nga vendet e punës është e nevojshme që t'i plotësojnë dhe **kushtet e përgjithshme** vijuese:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të përdorë gjuhën maqedone në mënyrë aktive;
- të jetë i moshës madhore;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- me aktgjykim gjyqësor të plotëfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Te drejtat dhe obligimet e tjera për secilin vend pune

Orë pune: 40 orë në javë

Ditë pune: e hënë - e premte;

Orari i punës nga ora 7:30 deri në orën 15:30.

Pushimi ditor: nga ora 11.00 deri në orën 11,30.

Aplikimi për punësim mund të merret në veb faqen e gjykatës www.osdebar.mk.

Kandidatët janë të obliguar që aplikimin ta plotësojnë në tërësi, në mënyrë precize dhe me të dhëna të sakta.

Aplikimi i plotësuar me dëshmitë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta në origjinal ose në kopje të vërtetuar te noteri, të dorëzohen në sportelin e pranimit të gjykatës ose nëpërmjet postës në adresën: Gjykata Themelore Dibër, rr. “Velko Vllahoviq” pn Dibër, me shënimin “Për konkursin publik nr.2/23”.

Afati i aplikimit është 5 ditë punë nga dita e publikimit të fundit në shtypin ditor (pa llogaritur ditën e shpalljes).

Aplikimi i plotësuar në mënyrë jo të rregullt, i pa kompletuar dhe i padorëzuar në kohën e duhur, ose aplikimi në të cilën janë dhënë të dhëna të rejshme nuk do të shqyrtohet.

Përzgjedhja do të bëhet më së voni në afat prej 15 ditë nga dita e skadimit të afatit të aplikimit.

GJYKATA THEMELORE DIBËR

Kryetar,

Mersim Marku